



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	09.10.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Besim TAHIRI Menaxher i Zyrës së Prokurimit – Prokurori i Shtetit
CC:	z. Shkëlzen MALIQI Drejtor i Përgjithshëm – Prokurori i Shtetit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me Automjete për Prokurorin e Shtetit (ritenderim II dhe III) "

I nderuari z. Tahiri ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Furnizim me Automjete për Prokurorin e Shtetit " (ritenderim III) me numër prokurimi: PSH250-14-016-121 , Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin e tenderit me titull " Furnizim me Automjete për Prokurorin e Shtetit " (ritenderim II dhe III) me numër prokurimi: PSH250-14-016-121 i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Prokurori i Shtetit.

Arsyetimi

Prokurori i Shtetit si Autoriteti kontraktues me dt.22.08.2014, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitur njoftimin për kontratë “ *Furnizim me Automjete për Prokurorin e Shtetit (ri-tender II)* ” i cili është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare me dt.04.09.2014 ka paraqitur Njoftimin për pjesëmarrje në vëzhgim me nr. protokoll Z-D/DPK-01-3103/14, përmes të cilit e ka njoftuar Autoritetin kontraktues se do të marr pjesë në monitorimin e vlerësimit të këtij tenderi. Mirëpo për shkak të pengesave teknike në komunikimin elektronik në mes Agjencisë dhe Autoritetit kontraktues, AKK e ka pasur të pamundur të merr pjesë në monitorimin e procesit të vlerësimit të këtij tenderi.

Me dt.15.09.2014 Autoriteti kontraktues ka paraqitur njoftim zyrtar në Agjenci rreth vlerësimit të tenderit me titull “ *Furnizim me Automjete për Prokurorin e Shtetit “ (ri-tender II)* ” me të cilin e ka njoftuar Agjencinë se ka pranuar vetëm një ofertë e cila pas vlerësimit nga ana e Komisionit vlerësues ka rezultuar si ofertë e papërgjegjshme, andaj në mungesë të ofertave të përgjegjshme ka rekomanduar anulimin e procedurës së prokurimit. Autoriteti kontraktues e ka ofruar në Agjenci njoftimin për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe e ka njoftuar AKK-në se i njëjti aktivitet është ri tenderuar përsëri.

Autoriteti kontraktues me dt.10.09.2014, përmes faqes elektronike të KRPP-së ka publikuar njoftimin për kontratë me titull “ *Furnizim me Automjete për Prokurorin e Shtetit “ (ri-tender III)* ”, me nr. të prokurimit: PSH250-14-016-121 Agjencia kundër Korrupsionit ka marrë pjesë në cilësinë e monitoruesit në vlerësimin e këtij tenderi. Gjatë monitorimit të këtij procesi të prokurimit, Agjencia ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Dosjen e tenderit për këtë kontratë e kanë pranuar 8 Operator ekonomik, ndërsa vetëm 1 Operator ekonomik e ka dorëzuar ofertën e tij për këtë tender.

Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve pas vlerësimit të ofertës së Operatorit të vetëm Ekonomik i cili ka tenderuar për këtë kontratë, konstatoi dhe erdhi në përfundim se ky Operator nuk është i përgjegjshëm dhe meqenëse nuk ka tenderë të përgjegjshëm ka rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti të Prokurimit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar dhe ekzaminuar me kujdes dokumentacionin e ofruar lidhur me këtë procedurë të prokurimit, dhe pas monitorimit që ka bërë në vlerësimin e këtij tenderi nuk ka hasur në ndonjë shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !